

**KONTRATË DHURIMI KUOTE KAPITALI**  
**( TË SHOQËRISË "ALVORA" SH.P.K)**

Sot, më datë 03 Mars 2021 (*dymijë e njëzet e një*), ne palët kontraktuese:

**PALA DHURURESE:**

**1. Zj. Floresh MEMLIKA**, atësia Qamil, amësia Sulltan, shtetase Shqiptare, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Pall.Beta, Ap.D35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 02.09.1959, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, përfaqësuar me letërnjoftim ID nr. 034481055 dhe nr. personal F95902016B, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 109 rep dhe nr. 42 kol., datë 27.02.2021, Notere Elona L. Saliaj, përfaqësuar nga **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W.


**2. Zj. Entela MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Roskovec, Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Nikolla Tupe"; Nd. 22; H. 6; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, e datëlindjes 11.07.1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftim ID nr. 035094854 dhe nr. personal I55711158H, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 109 rep dhe nr. 42 kol., datë 27.02.2021, Notere Elona L. Saliaj, përfaqësuar nga **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W.

**3. Zj. Edjona MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Lulëzim, Tepelenë dhe banuese në Vlorë, me adresë rr. "Misto Mele" 04140277; Nd. 20; H. 3; Ap. 39; Vlorë; Vlorë; 9401; Vlorë, e datëlindjes 01.06.1989, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, përfaqësuar me letërnjoftim ID nr. 034684271 dhe nr. personal I95601039F, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 109 rep dhe nr. 42 kol., datë 27.02.2021, Notere Elona L. Saliaj, përfaqësuar nga **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W.

**4. Zj. Esmeralda HAZIZAJ**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Medar Shtylla"; Nd. 058; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, e datëlindjes 14.04.1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftim ID nr. 036584512 dhe nr. personal I35414061P, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 109 rep dhe nr. 42 kol., datë 27.02.2021, Notere Elona L. Saliaj, përfaqësuar nga **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W. (*në cilësinë e ortakëve të shoqërisë "Alvora" sh.p.k., sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1767 rep dhe nr. 262 kol., datë 05.11.2020, Notere Elona L. SALIAJ; në cilësinë e dhuruesve të Shoqërisë "Alvora" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Dhurues"*).

**PALA PRANUESE E DHURIMI:**

**Zj. Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes



26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W. (në cilësinë e Pranueses së dhurimit të kuotës së Shoqërisë "Alvora" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Pranues Dhurimi**.)

Ne palët e sipërpërmendura, me vullnetin tonë të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 761 e vijues i tij, si dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", biem dakord dhe kërkojmë të hartojmë Kontratën e Dhurimit të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "**ALVORA**" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

## NENI 1

### PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

1.1 Shoqëria "**ALVORA**" sh.p.k, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar si person juridik në QKR (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) me numër Unik Identifikimi të subjektit K89105501K, e themeluar më datë 27.04.2008 dhe e regjistruar më datë 05.05.2008, me seli në Gjirokastrë, Tepelenë, Lagja "Selam Musai", afër drejtorisë së higjienës.

1.2 Shoqëria përbëhet nga një ortak i vetëm Arshi MEMLIKA, i cili ka ndërruar jetë më datë 25.08.2020 dhe për të cilin është lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore, me nr. 1767 rep dhe nr. 262 kol., datë 05.11.2020, Notere Elona L. SALIAJ. Ortakët e shoqërisë, pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë janë si më poshtë:

- **Zj. Floresh MEMLIKA**, ortake e shoqërisë "**ALVORA**" sh.p.k, e cila është pronare e një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotëruese e 20 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 380.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Zj. Entela MEMLIKA**, ortake e shoqërisë "**ALVORA**" sh.p.k, e cila është pronare e një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotëruese e 20 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 380.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Zj. Edjona MEMLIKA**, ortake e shoqërisë "**ALVORA**" sh.p.k, e cila është pronare e një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotëruese e 20 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 380.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Zj. Esmeralda HAZIZAJ**, ortake e shoqërisë "**ALVORA**" sh.p.k, e cila është pronare e një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotëruese e 20 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 380.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Zj. Olta MEMLIKA**, ortake e shoqërisë "**ALVORA**" sh.p.k, e cila është pronare e një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotëruese e 20 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 380.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë; Shoqëria ka si objekt veprimtarie: "Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, etj....."

1.3 Objekt i kësaj kontrate është **Dhurimi nga ana e Dhuruesve dhe pranimi i dhurimit nga ana e pranueses së dhurimit të një kuote**, që i përket 80% të kapitalit themeltar, që i korrespondon 1.520.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë "**ALVORA**" Sh.p.k., kundrejt pranueses së dhurimit në këtë mënyrë:

- Pranueses së dhurimit **Olta MEMLIKA**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket 80 % të kapitalit themeltar që i korrespondon 1.520.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë "**ALVORA**" Sh.p.k..

1.4 Kalimi i dhurimit të kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie nga ana e dhuruesit në masën 80 % gjithsej dhe **Pranimi i dhurimit nga ana e Pranueses së dhurimit të një kuote**, që i përket 80% të kapitalit themeltar, si më sipër, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së Dhuruesve mbi këtë kuotë dhe transferimin me të drejta të plota tek Pranuesja e Dhurimit, ku ortakja pranuese e Dhurimit **Olta MEMLIKA** bëhet pronare e vetme e një kuote, në masën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, që i korrespondon vlerës **1.900.000,00** lekë pjesë të zotëruara të Shoqërisë si pasojë e këtij trasanksioni dhurimi.

1.4 Në këtë mënyrë, me kalimin e pronësisë me anë të kësaj Kontrate Dhurimi të kuotës së kapitalit të Shoqërisë "**Alvora**" Sh.p.k, gjendja e pronësisë së kuotës ndryshon në këtë mënyrë:

- Dhurueset Floresh MEMLIKA, Entela MEMLIKA, Edjona MEMLIKA dhe Esmeralda HAZIZAJ, humbasin tërësisht pronësinë e një kuote, që i përket 80 % (nga 20% secila) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "ALVORA" Sh.p.k.
- Pranuesja e dhurimit Olta MEMLIKA, bëhet pronare dhe zotëruese e një kuote kapitali, të përbërë nga 100 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 1.900.000,00 lekë.

## NENI 2

### BAZA LIGJORE

- 2.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 761 dhe vijues të tij;
- 2.2 Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", me ndryshimet.
- 2.3 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet;

## NENI 3

### KALIMI I PRONËSISË

- 3.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë Dhurimi prodhon efektet juridike të parashikuara nga Neni 761 e vijues i Kodit Civil. Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj kontrate, kuota e shoqërisë regjistrohet në emrin e pranueses së shurimit Olta Memlika në masën 100% të kapitalit themeltar. Regjistrimi bëhet në QKB, ku pronësia me të drejta të plota e kuotës së shoqërisë, kalon tek pranuesja e dhurimit dhe pasqyrohen ndryshimet përkatëse. Pronësia kalon nëpërmjet dhurimit, pa kundër shpërblim nga dhuruesi tek pranuesja e dhurimit me të drejta të plota, e lirë nga çdo peng apo detyrim tjetër real dhe pa asnjë kusht dhe pranuesja e dhurimit është e lirë të bëjë regjistrimin e ndryshimeve të pronësisë menjëherë me paraqitjen e kësaj kontrate dhurimi.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesit e humbasin pronësinë mbi kuotën e kapitalit zotëruar që dhurojnë, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim apo përgjegjësi pronësie mbi këtë kuotë në shoqërinë "Alvora" sh.p.k. ndërsa Pranuesja e dhurimit bëhet pronare e vetme dhe e ligjshme e kuotës, duke e zotëruar atë tërësisht.
- 3.3 Menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala Pranuese e Dhurimit ka të drejtë të depozitojë kontratën në QKB, e cila nuk do të kalojë në pronësi të Pranueses së Dhurimit, kuotën e dhuruar.

## NENI 4

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 4.1 Për zbatimin dhe realizimin e kësaj kontrate dhurimi kote shoqërie, palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:

#### A. Të drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit:

- Dhuruesi merr përsipër dhe deklaron se kuota e shoqërisë objekt i kësaj kontrate dhurimi, është në pronësinë e tij dhe se këtë kuotë ia dhurojnë Pranueses së dhurimit, pa kundërshpërblim.
- Dhuruesi me nënshkrimin e kësaj kontrate, shpreh vullnetin për depozitim të kontratës së dhurimit të kuotës në QKB, dhe dakordësinë e regjistrimit për kalimin e pronësisë në favor të pranueses së dhurimit me të drejta të plota dhe pa asnjë kusht.

#### B. Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit të dhurimit:

- Pranuesi i dhurimit, me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon pronësia e kuotës dhe kontrata depozitohet në QKB, për të bërë ndryshimin e pronësisë.

#### C. Të drejtat dhe detyrimet dypalëshe:

- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi humbet çdo të drejtë pronësie si dhe çdo të drejtë tjetër për sa i përket pjesës së kuotës takuese të kapitalit të shoqërisë që ia dhuron Pranueses së dhurimit, duke u kaluar atyre çdo të drejtë dhe përgjegjësi mbi kuotën e shoqërisë.
- Pranuesja e dhurimit, si Ortake e Shoqërisë, ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të respektojë dispozitat përkatëse për njohjen e shoqërisë, duke marrë përsipër dhe duke njohur çdo të drejtë dhe detyrim të shoqërisë kundrejt të tretëve, si aktivin ashtu edhe pasivin e saj.

**NENI 5**  
**HEQJA DORË NGA TË DREJTAT**

5.1 Dhuruesi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate, ai heq dorë tërësisht nga të drejtat që i kanë takuar përgjatë periudhës së zotërimit të objektit të dhurimit në shoqëri, apo çdo të drejtë tjetër pa kufizim ku përfshihen të drejta pune, dividendi, asetet, etj.

**NENI 6**  
**REGJISTRIMI I AKTIT NOTERIAL NË QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE**

6.1 Palët deklarojnë se morën dijeni për kryerjen e regjistrimit të këtij akti noterial pranë QKB-së (*Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve*) Tiranë, për të bërë njoftimin përkatës dhe njohjen e kontratës. Kontrata e dhurimit depozitohet në QKB, ku do të bëhen ndryshimet përkatëse dhe kalimi i pronësisë sipas kontratës në referim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

**NENI 7**  
**INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI**

7.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

7.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

**NENI 8**  
**LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

8.1 Kjo kontratë, është hartuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij e vijues të tij si dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", me ndryshimet.

8.2 Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e tjera të Kodit Civil dhe në Legjislacionin përkatës.

8.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

8.4 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej tyre mund t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**NENI 9**  
**ANEKSET E KONTRATËS**

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me datë 03 Mars 2021;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "*ALVORA*" sh.p.k, datë 03.03.2021;
- Prokurë e posaçme nr. 109 rep dhe nr. 42 kol., datë 27.02.2021, Noter Elona L. SALIAJ;
- Lëshim dëshmi trashëgimie ligjore nr. 1767 rep dhe nr. 262 kol., datë 05.11.2020, Noter Elona L. SALIAJ.
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.



## NENI 10

### GJUHA E HARTIMIT TË KONTRATËS

10.1 Kontrata u hartua nga ne palët në gjuhën shqipe në 4 kopje (katër), me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje depozitohet në QKR-së (*Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve*) për t'u regjistruar transaksioni i kryer dhe kopjet e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

## NENI 11

### HYRJA NË FUQI

11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit të palëve në Prani të Noteres, nënshkrimit të saj nga unë Noterja dhe regjistrimit të Kontratës me nr. Repertori dhe Koleksioni në regjistrin Noterial.

## NENI 12


### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

12.1 Kontrata e Dhurimi të kuotave të kapitalit u lexua dhe u kuptua nga ne palët kontraktuese dhe deklarojmë se e kuptuam përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.


### PALËT KONTRAKTUESE

#### PALA DHURUESE


Floresh MEMLIKA, përfaqësuar me  
prokurë të posaçme nga Olta MEMLIKA

OLTA MEMLIKA 

Entela MEMLIKA, përfaqësuar me  
prokurë të posaçme nga Olta MEMLIKA

OLTA MEMLIKA 

Edjona MEMLIKA, përfaqësuar me  
prokurë të posaçme nga Olta MEMLIKA

Olta Memlika 

Esmeralda HAZIZAJ, përfaqësuar me  
prokurë të posaçme nga Olta MEMLIKA

Olta Memlika 

#### PALA PRANUESE E DHURIMIT

Olta MEMLIKA

OLTA MEMLIKA 





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELONA L. SALIAJ  
ADRESA Blv. "Bajram Curri", pallatet  
"1 Maj", shkalla nr. 9, kati parë  
TEL: 692816131



## PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 109

Nr. koleksioni: 42

Tirane më 27/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

Mat material përbëhet nga 5 fletë



A2021051780004586067



**PROKURË E POSAÇME**

Sot, më datë 27 Shkurt 2021 (dymijë e njëzet e një) para meje Notere Elona L. SALIAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Blv. "Bajram Curri", pallatet "1 Maj", shkalla nr. 9, kati parë, u paraqitën personalisht:

**E PËRFAQËSUAR:**

**Zj. Floresh MEMLIKA**, atësia Qamil, amësia Sulltan, shtetase Shqiptare, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Pall.Beta, Ap.D35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 02.09.1959, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 034481055 dhe nr. personal F95902016B.

**Zj. Entela MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Roskovec, Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Nikolla Tupe"; Nd. 22; H. 6; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, e datëlindjes 11.07.1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 035094854 dhe nr. personal I55711158H.

**Zj. Edjona MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Lulëzim, Tepelenë dhe banuese në Vlorë, me adresë rr. "Misto Mele" 04140277; Nd. 20; H. 3; Ap. 39; Vlorë; Vlorë; 9401; Vlorë, e datëlindjes 01.06.1989, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 034684271 dhe nr. personal I95601039F.

**Zj. Esmeralda HAZIZAJ**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Medar Shtylla"; Nd. 058; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, e datëlindjes 14.04.1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 036584512 dhe nr. personal I35414061P.

Të përfaqësuarat e mësipërme, me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, u paraqitën në zyrën time noteriale dhe kërkuan nga unë Noterja hartimin e kësaj prokure të posaçme në referim të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

"Ne të përfaqësuarat e mësipërme, emërojmë si përfaqësuese të posaçme **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën Yzberish, Pall.Beta, Apd 35; Nd. 035; H. 0; Ap. 999; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, e datëlindjes 26.07.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr.

*[Handwritten signatures]*



A202105178000455606

030468757 dhe nr. personal J35726019Ë, të cilës i japim të drejtë dhe kompetenca të plota që në emër dhe për llogarinë tonë, në mungesën tonë, të ketë të drejtë:

- Të paraqitet në çdo organ/autoritet/institucion të administratës publike/shtetërore ose/dhe private, në institucionet qendrore dhe/ose vendore, veçanërisht, por pa u kufizuar:

- Përfaqësuesja jonë ka të drejtë që në emrin tonë si ortakë të shoqërisë "Alvora" sh.p.k., me NUIS K89105501K, të ketë të drejtë të nënshkruajë Vendim asambleje për marrje vendimesh të ndryshëm, të tilla si: ndryshim administratori, nënshkrim kontrate shitje, shkëmbim, kontratë dhurimi (në këtë rast përfituese të jetë vetëm përfaqësuesja jonë Olta Memlika) shfuqizim kontrate, nënshkrim kontratë blerje, porosie, sipërmarrje, etj. Përfaqësuesja jonë ka të drejta të plota të veprojë mbi llogaritë bankare që janë në emër të shoqërisë në të gjitha degët e bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, në të gjitha llojet e llogarive të hapura për shoqërinë, në monedhë vendase dhe/ose të huaj, kryerjen e veprimeve të tilla si: transfertë bankare (brenda dhe jashtë Shqipërisë), tërheqje, mbyllje dhe/ose hapje llogarish, të ketë të drejtë të kërkojë postën e bankës, ta rinovojë atë. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paraqitet edhe në emrin tonë si ortakë të shoqërisë në çdo institucion/zyrë të sipërpërmendur për të kërkuar, nënshkruar dhe/ose dorëzuar dokumente/formularë, shkresa, fatura, vërtetime, certifikatë, etj.

- Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paraqitet në QKB (qendrën kombëtare të regjistrimit të biznesit), me qëllim për të kërkuar regjistrimin e vendimit të asamblesë, të kontratave të ndryshme, deklarata, etj. Për këtë qëllim, në lidhje me shoqërinë "Alvora" sh.p.k., me NUIS K89105501K, përfaqësuesja jonë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për përfaqësimin e shoqërisë, pa kufizim, në të gjitha institucionet që kanë lidhje me biznesin për të kërkuar, dorëzuar dhe/ose nënshkruar çdo lloj dokumentacioni të kërkuar për shlyerjen e detyrimeve të tij, përfshirë edhe veprime bankare në çdo degë banke të nivelit të dytë, pa kufizim. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paraqitet në institucionet përkatëse me qëllim kërkimin e dokumentacioneve për sigurimet shoqërore, shëndetësore, taksat dhe tatime të ndryshme, detyrimet për energji elektrike, vërtetime të ndryshme, taksën e bashkisë etj. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të kërkojë mbylljen, hapjen, rihapjen e kontratave përkatëse me energji elektrike dhe ujësjellës në emër të shoqërisë, etj. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të pezullojë shoqërinë, ka të drejtë të bëjë likuidimin e shoqërisë, mbylljen e shoqërisë, etj., ka të drejtë të na përfaqësojë në cilësinë e palës shitëse për shitjen e kuotave të mia të kapitalit. Ka të drejtë të na përfaqësojë në dhurimin e kuotave të kapitalit, ku si palë pranuese e dhurimit të jetë vetëm përfaqësuesja jonë Olta MEMLIKA. Ka të drejtë të nënshkruajë vendimet e asamblesë për çdo lloj rendi dite, pa kufizim.

- Të përdorë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, të ketë të drejtë të japë në huapërdorim dhe të ketë të drejtë të dhurojë automjetin që kemi në bashkëpronësi automjeti Marka Volkswagen, lloji Autoveturë, me targë 226JD, lënda djegëse Naftë, me ngjyrë zezë, nr. vendesh 4+1. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë që t'ia dhurojë automjetin me të dhënat e sipërcituar në emrin e Floresh MEMLIKA.





A2021051780004816067

Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paraqitet në Drejtorinë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor për të regjistruar dëshminë e trashëgimisë dhe më pas të paraqitet në çdo zyrë noteriale me qëllim nënshkrimin e kontratës së dhurimit në emrin tonë **ku pranuese e dhurimit do të jetë Floresh MEMILKA.**

Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paguajë çdo detyrim në lidhje me automjetin e sipërcituar si taksa, siguracione, gjoba, etj. Ne të përfaqësuarat deklarojmë se që nga ky moment i japim të drejtë dhe kompetenca të plota përfaqësueses tonë të kryejë çdo lloj shërbimi dhe përdorimi të automjetit në bashkëpronësinë tonë, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, të ketë të drejtë të kryejë kolaudimin, kontrollin tekniko-fizik të automjetit, të pajiset me vërtetim për shlyerje detyrimesh, etj., duke pasur tagra të plota mbi automjetin. Nga dita e sotme ia dorëzojmë fizikisht automjetin dhe për gjithçka do të përgjigjet përfaqësuesja jonë e posaçme.

- Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të depozitojë dëshminë e trashëgimisë në çdo degë banke të nivelit të dytë në Shqipëri ku ka pasur llogari bankare i ndjeri babai ynë Arshi Memlika dhe ka të drejtë që për pjesën tonë takuese të vlerës monetare që përfitojmë nga çelja e trashëgimisë ligjore nga i ndjeri babai ynë, të kryejë të gjitha veprimet bankare të lejuara nga ligji, duke i dhënë të drejtë që të kryejë transfera llogarie vetëm në emrin e nënës tonë **Floresh Memlika** si përfituese llogarive, ka të drejtë të bëjë depozitime, veprime me çeqe bankare, këmbime, mbyllje të llogarive, shlyerje të plotë të depozitave ose llogarive bankare, çdo lloj transaksioni bankar pa kufizime në vlerë, monedhë dhe natyrë, transferime në llogarinë personale të Floresh MEMLIKA, kërkimin e postës së bankës (gjendjes së llogarive sipas periudhave që dëshiron përfaqësuesja ime), kërkimin dhe/ose rinovimin e kartës së bankës, mbylljen e llogarisë si dhe çdo veprim tjetër bankar pa asnjë kufizim, etj.; ku përfaqësuesja jonë ka të drejtë ti administrojë vetë këto llogari edhe për pjesën tonë takuese. Përfaqësuesja jonë ka të drejtë të administrojë vetë atë vlerë monetare edhe për pjesën tonë takuese, pa pasur asnjë pretendim nga ana jonë.

- Gjithashtu përfaqësuesja jonë ka të drejtë të paraqitet në emrin tonë në cilësinë e ortakeve të shoqërisë "**Alvora**" sh.p.k., me NUIS K89105501K, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor përkatës ose në çdo shkallë tjetër gjykimi në Republikën e Shqipërisë, si në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Administrative, në organet e policisë, prokurorisë, zyra noteriale, zyrat e përmbarimit gjyqësor, privat/shtetëror; etj, si dhe në çdo organ të administratës shtetërore/publike ose private në Territorin e Republikës së Shqipërisë, që lidhet ose del nga rrethanat e çështjes dhe që ka lidhje me mbrojtjen e interesave tona pasurore ose/dhe jo pasurore si individ ose në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**Alvora**" sh.p.k., me NUIS K89105501K, për të na përfaqësuar totalisht në çdo konflikt apo gjykim civil, administrativ, dhe/ose penal, me çfarëdo lloj objekt gjykimi, ku unë mund të jemi në cilësinë e palës së paditur, palës paditëse ose palës së interesuar. Për këtë qëllim, përfaqësuesja jonë ka të drejtë të hartojë dhe nënshkruajë kërkesa, padi, kundërpadi, ankime, apeline e kundërshtime të tyre, të caktojnë dhe emërojnë avokat, ose/dhe person të tretë sipas ligjit, për të bërë përfaqësimin e shoqërisë, edhe në mungesën tonë, duke i dhënë tagra të plota përfaqësimi në të gjitha gjykimet civile,



A2021051780004556067

administrative dhe/ose penale pa asnjë kufizim, duke përfshirë edhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, përfaqësuesja jonë ka të drejtë të na përfaqësojë në hetimin ose gjykimin e çështjeve në ngarkimin e shoqërisë ose në rastet kur jemi palë e interesuar, ose palë paditëse nëse do të jetë e nevojshme, para organeve kompetente; të kryejë çdo veprim të nevojshëm ligjor e procedural pa asnjë kufizim, vetë ose duke i dhënë të drejtë një avokati të emëruar prej saj, të ketë të drejtë të hartojë ose nënshkruajë dokumente të tilla: *kërkesa, ankime, padi, kundërpadi, apeline, rekurse e kundërshtime të tyre; prapësime, marrëveshje, kërkesë për sigurim padie, formularë, kallëzim, ankime administrative; të kërkojë, aplikojë dhe paraqesë prova shkresore ose me dëshmitarë, të paraqesë prova të tjera që do ti konsiderojë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, gjykimin e shkurtuar; të japë dëshmi, ose ta zgjidhë çështjen me ndërmjetësim, të shtojë ose pakësojë dhe/ose ndryshojë objektin e padisë dhe/ose të shkakut ligjor; të paraqesë dhe nënshkruajë kërkesën për lëshim urdhër-ekzekutimi, për vënien në ekzekutim të vendimit, të kundërshtojë veprimet e përmbaruesve në rrugë administrative ose gjyqësore; të bëjë kallëzime penale për çdo lloj vepre penale, të kërkojë fillimin e procedimit penal nëse i përfaqësuari dëmtohet nga vepra penale, të caktojë ekspertë, likuidatorë, të ketë të drejtë që vlerën monetare që unë përfitoj të urdhërojë që të transferohet në llogarinë time personale, etj. Në rast të ekzekutimi përmbarimor për vlerë monetare, përfaqësuesja jonë mund të kërkojë që ky ekzekutim të bëhet në llogarinë e saj personale.*

- Kjo prokurë e posaçme hartohet me vullnetin tonë të lirë e të plotë, sipas objektit të sipërcituar. Për këtë arsye, përfaqësuesja e emëruar prej nesh i ka të gjitha fuqitë ligjore të na përfaqësojë dhe nënshkruajë çdo akt/dokument, formular, shkresë, etj. në emër dhe për llogarinë tonë dhe/ose të kryejë çdo veprim procedural të nevojshëm, e cila edhe pse nuk është përmendur shprehimisht në këtë prokurë të posaçme, është brenda objektit të prokurës dhe nuk kemi asnjë pretendim për sa kohë veprimet janë kryer nga përfaqësuesja e emëruar prej nesh me tagra të plota dhe të pa kufizuara”.

Kjo prokurë është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe pa kufizim kohor, pra është e vlefshme në çdo kohë pa qenë nevoja e rinovimit të saj në të ardhmen, me të drejtën e shfuqizimit të saj në çdo kohë nga ana ime.

Të përfaqësuarat deklaruan se: *“Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesja jonë e posaçme në mbështetje të të drejtave që na njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsiderojmë të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë nesh”.*

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarave, të cilat më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noteres.

Kjo Prokurë e posaçme u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Njëra kopje së bashku me pullën e taksës 200 lekë,



A2021091780004556067

vendoset në arshivën noteriale dhe kopjet e tjerë i jepen të përfaqësuarave. Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarave nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", neni 62, neni 63 dhe neni 99 i tij; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale" me ndryshimet; Unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj prokure, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**TË PËRFAQËSUARA**

Floresh Memlika

*Floresh Memlika*

Entela Memlika

*Entela Memlika*

Edjona Memlika

*Edjona Memlika*

Esmeralda Hazizaj

*Esmeralda Hazizaj*

NOTERJA  
ELONA L. SALIAJ

*[Large signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K89105501K
2. Data e Regjistrimit	05/05/2008
3. Emri i Subjektit	ALVORA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	27/04/2008
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/04/2008
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Gjirokaster Tepelene TEPELENE Lagjia Selam Musai, afer Drejtorise se Higjenes
8. Kapitali	1.900.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore. Rikonstruksione. Ndertim rruges, ndertim urash dhe vepra arti. Ndertim ujesjellsa-kanalizime e impiante vaditje. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge. Prodhim materiale inerte, tregti e pergjithshme, mallra e material te ndryshme, ushqime, makineri bujqesore paisje elektronike. Paisje industrial, elektrike, hidraulike, paisje guzhine, bar-kafe, mobileri, makineri te ndryshme industriale, punime hekuri, elektrike, punime guri. Blerje paisje per automjete. Blerje paisje per rrobaqepsi. Blerje paisje per saldime. Blerje makineri e paisje. Blerje kondicionere e vendosje. Blerje paisje parukerie. Tregtim materjale ndertimi. Prodhim inerte. Tregtim pajisje elektronike. Punime dualumini. Blerje dhe furnizime kancelari, shtypshkrimi. Lyerje objekte te ndryshme ndertimore. Punime rere. Furnizim vendosje tabela sinjalistike te jashtme dhe te brendshme , si dhe sinjalistike rrugore. Riparime kompjuterike. Punime mobilerie. Furnizime vendosje xhamash. Punime dhe sistemim lulishte, mbjellje dhe prerje bimesh te vogla, peme dekorative etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	Punime moketi. Punime elektrike, hidraulike, llamarine, saldime. Punime rrobaqepsie. Sherbim pastrim i ambienteve te brendshme dhe te jashtme. Larje fasade xhami. Sherbim recepsioni. Punime gjelberimi dhe sistemim lulishte. Furnizim montim panele diellore. Riparim dhe mirembajtje ashensori. Furnizim dru zjarri.Prodhim dhe tregetim tubo betoni te dimensioneve te ndryshme.Prodhim dhe tregetim blloqe e puseta betoni. Tregetim inertesh. Ndertim ura te varura kembesore. Ndertim ura bel. Ndertim urash dhe vepra arti. Punime hidroizolimi	
10. Administratori/ët	Olta Memlika	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 09/08/2020	Deri: 08/08/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	Znj. Olta Memlika ka te drejta te plota ne marrdhenie financiare lidhje kontratash, veprime bankare etj..	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Administratori/ët	Arshi Memlika	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 28/10/2014	Deri: 28/10/2024
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
14. Ortakët	ArshiMemlika	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.900.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	100,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ALVORA E-Mail: arshi_memlika@yahoo.com Telefon: 08142933 Të Tjera: Miratimin e z.Luan Muça me nr. liçence 119 date 20.02.2000 si ekspert kontabel te autorizuar per hartimin e nje raporti mbi mundesine e zmadhimit te kapitalit. Baftjar Xhebro do te jete drejtues teknik i ALVORA sh.p.k me seline ne Tepelene.	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

17. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 03/03/2021

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga  
Qendra Kombëtare e Biznesit  
Date:2021/03/03 10:56:34 +01:00  
K89105501K2021030310561588  
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELONA L. SALIAJ  
ADRESA Blv. "Bajram Curri", pallatet  
"1 Maj", shkalla nr. 9, kati parë  
TEL: 692816131



# VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 1767

Nr. koleksioni: 262

Tirane më 05/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë



A2020051780026642282



## LËSHIM DËSHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

Sot, më datë 05 Nëntor 2020 (*dymijë e njëzet*), ditë e Enjte, ora 15.00, nga Notere **Elona L. SALIAJ**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë Noterie në Tiranë, me adresë Blv. "B. Curri", P. "1 Maji", shkalla nr. 9, kati 1, u mor në shqyrtim kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga:

**KËRKUES:** **Olta MEMLIKA**, atësia Arshi, amësia Floresh, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë "Yzberish", Pall. "Beta", Ap. 35; Kashar, Yzberish; e datëlindjes 26.07.1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W.

**OBJEKTI:** Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Arshi Selim MEMLIKA**.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "*Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë*", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e saj, Unë Noterja kryesisht, në referim të nenit 111, 113 të ligjit nr. 110/2018 "*Për Noterinë*", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Notere **Elona L. SALIAJ**, me zyrë Noterie në Tiranë, Blv. "B. Curri", Pallatet "1 Maji", shk. 9, kati 1, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

### VËREJ SE:

#### 1. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja **Olta MEMLIKA**, më ka paraqitur një kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin të ndjerin babin e saj **Arshi MEMLIKA**, më datë 03.11.2020, përpara meje Notere **Elona L. SALIAJ**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Blv "B. Curri", Pallatet "1 Maji", shk. 9, kati 1; në të cilën ka disponuar mbi kërkimet e saj dhe shpjegimet përkatëse.



A2020021730026642182

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se, **Arshi MEMLIKA** (*trashëgimlënësi*), babai i kërkueses, ka ndërruar jetë më datë 25.08.2020, referuar certifikatës së vdekjes nr. akti 120, datë 31.08.2020, lëshuar nga zyra e gjendjes civile, njësia Bashkiake Tiranë, datë 15.10.2020. Vendbanimi i fundit i të ndjerit ka qenë Bashkia Tiranë, Zyra e Gjendjes Civile Tiranë.

3. I ndjeri **Arshi MEMLIKA** rezulton të ketë pasur vetëm një martesë me **Floresh MUÇOBEGA**. Nga martesë rezulton të kenë ardhur në jetë 4 (katër) fëmijë: **Esmeralda HAZIZAJ, Entela MEMLIKA, Edjona MEMLIKA dhe Olta MEMLIKA**. Gjithashtu, ky fakt provohet edhe nga certifikatat e gjendjes familjare e vitit 01.08.1991, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Tiranë.

4. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e noteres, kërkuësja sqaroi se nuk ka dijeni që trashëgimlënësi të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, nuk ka pasur martesë të tjera ose fëmijë jashtë martese, dhe për sa i përket regjimit pasuror martesor, nuk rezulton tjetër veç atij të bashkësisë ligjore. Gjithashtu, shpjegoi se asnjë prej trashëgimtarëve ligjorë nuk ka hequr dorë nga trashëgimia, ose të jetë bërë i padenjë për të trashëguar. Për këto arsye, kërkuësja më kërkoi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të të ndjerit **Arshi MEMLIKA** (*trashëgimlënës*), duke thirrur si trashëgimtarë të radhës së parë bashkëshorten e të ndjerit dhe fëmijët e tij, përkatësisht: **Floresh MEMLIKA** (bashkëshortja e trashëgimlënësit); **Esmeralda HAZIZAJ** (e bija e trashëgimlënësit); **Entela MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit); **Edjona MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit) dhe **Olta MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit).

## II. Vlerësimi i Noteres

### Lidhur me legjitimitetin e kërkuësit

5. Referuar të drejtës subjektive procedurale, çdo individ ka të drejtën t'i drejtohet Shërbimit Noterial për të kërkuar një interes të ligjshëm siç është lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë. Kjo e drejtë, i jepet vetëm atij i cili pretendon se ka një interes të ligjshëm në kërkimin e tij për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Kjo kërkesë, vihet në lëvizje nga personi i interesuar, i cili duhet të provojë përpara Noterit se ka interes (*personal, të lindur, të ligjshëm*) për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

6. Referuar provave shkresore të paraqitura nga kërkuësja dhe të administruara si të tilla, konkretisht nga certifikata e përbërjes familjare, lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile, vlerësoj se kërkuësja legjitimohet në paraqitjen e një kërkesë të tillë për sa kohë ajo rezulton të jetë vajza e trashëgimlënësit, referuar nenit 360 të Kodit Civil dhe për këtë arsye, bën pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë. Në një konkluzion të tillë arrihet duke pasur parasysh kërkesën për lëshimin e



A202005178002642782

dëshmisë së trashëgimisë; në të cilën përcaktohen trashëgimlënësi, trashëgimtarët dhe pjesët e tyre ideale në pasurinë trashëgimore; kanë të drejtë ta paraqesin para *Noteres* personat që janë trashëgimtarë të trashëgimlënësit ose që pretendojnë se janë të tillë dhe që thirren në trashëgim sipas përcaktimeve ligjore dhe atyre testamentare.

### **Lidhur me çeljen e trashëgimisë ligjore**

8. Për të dokumentuar lindjen e marrëdhënies juridike të trashëgimisë është e nevojshme, që personat e interesuar t'i drejtohen Shërbimit Noterial, duke kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, referuar nenit 348 të Kodit Civil, "*Dëshmia e trashëgimisë*" sipas të cilit "*Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë kod dhe në ligjin për noterinë. Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite, në harmoni edhe me kuptimin e zbatimin e drejtë të dispozitave të tjera materiale e procedurale civile të lidhura me trashëgiminë, është e kuptueshme se dëshmia e trashëgimisë, si një vërtetim fakti, "*lëshohet nga noteri*". Me dëshminë e trashëgimisë, pasi konstatohet vdekja e trashëgimlënësit dhe çelja e trashëgimisë, vërtetohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të asaj radhe që thirret në trashëgim në rastin e trashëgimisë ligjore, ose trashëgimtarëve të cilëve me testament u është lënë pasuria trashëgimore, si dhe pjesa takuese e secilit në këtë pasuri.

9. Gjatë lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, fillimisht duhet të provohet vdekja e trashëgimlënësit, e cila përcakton dhe momentin e çeljes së trashëgimisë. Me çelje të trashëgimisë kuptohet vërtetimi i atyre rrethanave, fakteve juridike të cilat përcaktojnë lindjen e marrëdhënies së trashëgimisë. Si fakt juridik që shërben për çeljen e trashëgimisë është vdekja e trashëgimlënësit ose shpallja e tij si i vdekur. Trashëgimia çelet kur vërtetohet njëra nga këto dy rrethana dhe sjell kalimin e të drejtave pasurore të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët e tij ligjorë ose testamentarë. Pra, me vdekjen e trashëgimlënësit (*de cuius*), si një fakt juridik, ligjvënësi lidh edhe çastin e lindjes së marrëdhënies juridike të trashëgimisë dhe pikërisht nga ky moment lindin të drejtat dhe detyrimet e trashëgimtarëve mbi pasurinë trashëgimore.

10. Me çeljen e trashëgimisë, janë të lidhur koha dhe vendi i çeljes së saj. Koha e çeljes së trashëgimisë është caktuar nga ligji dhe i korrespondon kohës së vdekjes së trashëgimlënësit. Me kohën e çeljes së trashëgimisë, *inter alia*, lidhen: (i) përcaktimi i vëllimit të të drejtave pasurore dhe detyrimeve që u kalojnë trashëgimtarëve; (ii) përcaktimi i rrethit të trashëgimtarëve (*nenet 320, 321 të K. Civil*); (iii) ecja e afateve që lidhen me marrëdhënien e trashëgimisë (*335 i K. Civil*); (iv) ligji i zbatueshëm (*neni 318 i K. Civil*). Nga aktet e administruara në cilësinë e provës shkresore, konkretisht nga certifikata e vdekjes së trashëgimlënësit,





A2020051730026642282

konstatohet se trashëgimlënësi ka ndërruar jetë më datë 25.08.2020, referuar certifikatës së vdekjes nr. akti 413, datë 13.10.2020, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Tiranë. Në këto kushte, lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore, ku do të përcaktohen edhe rrethi i trashëgimtarëve dhe pjesët takuese të tyre do të bëhet në referim të Kodit Civil që është në fuqi.

11. Pas konstatimit të vdekjes së trashëgimlënësit dhe përcaktimit të ligjit material të zbatueshëm në rastin konkret, Noterja vërteton rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të asaj radhe që thirret në trashëgim në rastin e trashëgimisë ligjore, ose trashëgimtarëve të cilëve me testament u është lënë pasuria trashëgimore, si dhe pjesa takuese e secilit në këtë pasuri.

12. Gjithashtu, referuar nenit 317 të Kodit Civil, ku parashikohet shprehimisht se: *“Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament”*, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore mbaj parasysh faktin se rregullat e trashëgimisë ligjore (*ab intestat*) gjejnë zbatim kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament. *Nga shpjegimet e kërkueses dhe verifikimit në Regjistrin e Përgjithshëm të Testamenteve dhe Regjistrin e Dëshmive të Trashëgimisë Ligjore në platformën NISA dhe në sistemin RNSH e konfirmuar “Aprovuar”, siç rezultojnë me kthim përgjigjen të platformës NISA nr. 116519, datë 04 Nëntor 2020 dhe siç rezultojnë me kthim përgjigjen të platformës RNSH nr. 141487, datë 04 Nëntor 2020 nga Dhoma Kombëtare e Noterisë Tiranë, konstatohet se nuk rezultojnë që trashëgimlënësi Arshi Selim MEMLIKA të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, nuk rezultojnë që të jetë lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore ose dëshmi trashëgimie testamentare. Në këto kushte, do të zbatohen rregullat e trashëgimisë ligjore. Në rastet kur zbatohet trashëgimia ligjore, të drejtat pasurore të trashëgimlënësit i kalojnë personave të caktuar nga ligji si trashëgimtarë të cilët quhen trashëgimtarë ligjorë dhe që thirren në trashëgim sipas një radhe të përcaktuar në ligj.*

13. Në përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve ligjorë, i referohemi nenit 360 të Kodit Civil, ku parashikohet se: *“Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të para vdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas radhës të caktuar në këtë Kod”*. Gjithashtu, në përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve në rastin objekt shqyrtimi mbaj parasysh nenin 361 të Kodit Civil, ku parashikohet se: *“Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi apo është përjashtuar nga trashëgimia, në vend të tij hyjnë me*



A2020051780026642382

zëvendësimin fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prinçit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta. Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi. Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit. Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimi i mbetet bashkëshortit pasjetues”.

14. Referuar në provat shkresore të paraqitur nga kërkuesja dhe të administruara si të tilla nga unë Noterja, konkretisht nga certifikata e vdekjes, rezulton se i ndjeri **Arshi MEMLIKA** në kohën e vdekjes ka qenë me status civil “**I Martuar**”. Gjithashtu, nga certifikata e përbërjes familjare, rezulton se në trungun familjar të të ndjerit **Arshi MEMLIKA**, janë bashkëshortja dhe fëmijët e tij, përkatësisht: **Floresh MEMLIKA** (bashkëshortja e trashëgimlënësit); **Esmeralda HAZIZAJ** (e bija e trashëgimlënësit); **Entela MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit); **Edjona MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit) dhe **Olta MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit).

15. Gjithashtu, për të arritur në identifikimin e saktë ligjor dhe faktik të trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të cilët përfitojnë nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, mbaj parasysh edhe faktin se përfitimi i të drejtave pasurore me anë të trashëgimisë lidhet gjithmonë me pasjen e zotësisë për të trashëguar nga ana e trashëgimtarëve. Në këtë kuptim, zotësia për të trashëguar është mundësia që u jep ligji personave të caktuar për të qenë trashëgimtarë, për të fituar të drejta pasurore me anë të trashëgimisë, si një nga institutet e fitimit të pronësisë. Pasja e zotësisë për të trashëguar si një kusht ligjor në përfitimin e pasurisë trashëgimore është e lidhur ndër të tjera edhe me qenien gjallë të personit në kohën e çeljes së trashëgimisë, siç identifikohet edhe nga përmbajtja e nenit 320 e Kodit Civil, ku konkretisht parashikohet se: “*Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë...*”.

16. Nga aktet e administruara në cilësinë e provave shkresore, konkretisht: **1.** Certifikatë e përbërjes familjare e vitit 1974, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Krahës, Bashkia Memaliaj, Zyra Gjendjes Civile datë 02.10.2020; **2.** Certifikatë e përbërjes familjare e vitit 1986-2008, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Memaliaj, njësia administrative Krahës, datë 02.10.2020; **3.** Certifikatë e përbërjes familjare e vitit 01.08.1991, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Bashkia Memaliaj, Njësia Administrative Krahës, datë 02.10.2020; **4.** Certifikatë e përbërjes familjare e vitit 01.01.2010, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Tiranë, Njësia Administrative



A3020031780026642282

Kashar, datë 02.10.2020; 5. Certifikatë e përbërjes familjare e datës 01.04.2014, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Tiranë, datë 02.10.2020; 6. Certifikatë e përbërjes familjare datë 01.12.2016, lëshuar nga Njësia Administrative Kashar, Tiranë, datë 02.10.2020; 7. Certifikatë e përbërjes familjare e datës 01.09.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Tiranë, Njësia Administrative Kashar, datë 02.10.2020; 8. Certifikatë e përbërjes familjare e datës 24.08.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Tiranë, Njësia Administrative Kashar, datë 02.10.2020; 9. Certifikatë Martese (nga Akti) nr. akti 38, datë 17.08.1981, lëshuar nga Qarku Gjirokastrë, Rrethi Tepelenë, datë 08.09.2020; 10. Certifikatë Vdekje (nga Akti), nr. akti 120, datë 31.08.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Tiranë, vulosur elektronikisht nga Zyra e gjendjes civile; 11. Certifikatë personale Floresh MEMLIKA, e aksesuar online nga unë Noterja sot më datë 05.11.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, vulosur elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile. 12. Certifikatë personale Esmeralda HAZIZAJ (mbiemri i vajzërisë "Memlika"), e aksesuar online nga unë Noterja sot më datë 05.11.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, vulosur elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile. 13. Certifikatë personale Entela MEMLIKA, e aksesuar online nga unë Noterja sot më datë 05.11.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, vulosur elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile. 14. Certifikatë personale Edjona MEMLIKA, e aksesuar online nga unë Noterja sot më datë 05.11.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, vulosur elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile. 15. Certifikatë personale Olta MEMLIKA, e aksesuar online nga unë Noterja sot më datë 05.11.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, vulosur elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile.

17. Në këto kushte, referuar nenit 361 paragrafi i parë i Kodit Civil, çmoj se si trashëgimtarë të radhës së parë të të ndjerit **Arshi MEMLIKA**, atësia Selim, amësia Shefiko, datëlindja 17.06.1957, Gjinia Mashkull, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe vendbanimi i fundit në Tiranë, me adresë Yzberish, gjendja civile në çastin e vdekjes "I Martuar", data e vdekjes 25.08.2020, nr. akti 120, datë 31.08.2020, nr. personal F70617106I; **thirren:**

**a. Floresh MEMLIKA** (bashkëshortja e trashëgimlënësit) atësia Qamil, amësia Sulltan, me shtetësi Shqiptare, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Pall. Beta, Kashar, Yzberish; gjendja civile "e ve", e datëlindjes 02.09.1959, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 034481055 dhe nr. personal F95902016B.

**b. Esmeralda HAZIZAJ** (e bija e trashëgimlënësit), atësia Arshi, amësia Floresh, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Medar Shtylla"; Njësia Administrative Nr. 5; gjendja civile "e martuar", e datëlindjes 14.04.1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për



A202009178002664232

identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 024623713 dhe nr. personal I35414061P.

**c. Entela MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit), atësia Arshi, amësia Floresh, shtetase Shqiptare, lindur në Roskovec, Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Nikolla Tupena", Nd. 22; H. 6; Njësia Administrative Nr. 5; gjendja civile "e martuar", e datëlindjes 11.07.1985, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 035094854 dhe nr. personal I55711158H.

**d. Edjona MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit), atësia Arshi, amësia Floresh, me shtetësi Shqiptare, lindur në Lulëzim, Tepelenë dhe banuese në Vlorë, me adresë Rr. "Misto Mele", Nd. 20; H. 3; Ap. 39; gjendja civile "e martuar", e datëlindjes 01.06.1989, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 034684271 dhe nr. personal I95601039F.

**e. Olta MEMLIKA** (e bija e trashëgimlënësit), atësia Arshi, amësia Floresh, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Pall. Beta, Kashar, e datëlindjes 26.07.1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 030468757 dhe nr. personal J35726019W.

18. Pasi verifikova edhe disa kushte të tjera ekzistenca e të cilave mund të ndryshojë përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë, më konkretisht: Nuk rezultoi që trashëgimlënësi të ketë përjashtuar nga trashëgimia ndonjë nga trashëgimtarët ligjorë (*neni 378 i Kodit Civil*). Gjithashtu pas verifikimit të bërë në Regjistrin e Përgjithshëm të Testamenteve, Regjistrin e Përgjithshëm të Dëshmive të Trashëgimisë, të administruar nga DHKN dhe siç rezultoi me kthim përgjigjen nga Dhoma Kombëtare e Noterisë Tiranë, nuk rezultoi që trashëgimlënësi të ketë lënë testament; që për trashëgimlënësin të jetë lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore, si dhe nuk konstatohet ndonjë shkak që i bën trashëgimtarët të paaftë për të trashëguar (*neni 322 i Kodit Civil*).

#### **Në lidhje me trashëgimin**

19. Në lidhje me kuptimin dhe masën e pasurisë trashëgimore që përfitojnë trashëgimtarët nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit çmoj se, bashkëtrashëgimtarët ligjorë të radhës së parë në trashëgiminë ligjore të çelur, paraqiten si trashëgimtarë me titull universalë në të drejtat dhe detyrimet trashëgimore. Për të tillë trashëgimtarë, pasuria do të jetë gjenerike dhe me titull universal, ku do të përfshihen edhe pasuritë që nuk njiheshin prej trashëgimlënësit, por që në momentin e çeljes së trashëgimisë janë të disponueshme. Gjithashtu, këta trashëgimtarë në përpjesëtim me pjesën ideale gjenerike të pasurisë së përfituar, do të përgjigjen gjenerikisht edhe kundrejt detyrimeve që rëndojnë atë pasuri, brenda





A2020051780026642582

kufijve të tyre (*intra vires hereditatis*). Kjo gjë, bën që trashëgimtarët të marrin pjesët e tyre ideale pa i njohur ose pa qenë nevoja të njohin konkretisht sendet që përbëjnë pasurinë trashëgimore. Për pasojë, vetë pasuria trashëgimore vihet detyrimisht nën të njëjtin regjim juridik që pas sjell se sende, ose të drejta të veçanta të saj, të ndjekin të njëjtin regjim trashëgimorë trashëgiminë në tërësi.

### PËR KËTO ARSYE:

**Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360, e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, gërma d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”;**

### V E N D O S A:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Arshi MEMLIKA**, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë:
  - **Floresh MEMLIKA** (*bashkëshortja e trashëgimlënësit*) **1/5 (një të pestën pjesë);**
  - **Esmeralda MEMLIKA** (*e bija e trashëgimlënësit*) **1/5 (një të pestën pjesë);**
  - **Entela MEMLIKA** (*e bija e trashëgimlënësit*) **1/5 (një të pestën pjesë);**
  - **Edjona MEMLIKA** (*e bija e trashëgimlënësit*) **1/5 (një të pestën pjesë);**
  - **Olta MEMLIKA** (*e bija e trashëgimlënësit*) **1/5 (një të pestën pjesë);**të cilët trashëgojnë secili në mënyrë të barabartë nga **1/5 (një të pestën) pjesë** të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.
3. Kërkuesja mori dijeni dhe iu sqarua nga Noterja detyrimi ligjor për depozitim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (*tridhjetë ditë kalendarike*), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.
4. Referuar akteve të administruara dhe shpjegimeve të kërkueses, nuk rezulton që trashëgimlënësi (*de cuius*), të ketë nënshkruar kontratë për ndryshimin e regjimit pasuror martesor me bashkëshorten e tij, pra përgjatë martesës kanë pasur regjim pasuror në bashkësi ligjore. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituar gjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës





A2020091780626642282

takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues në referim me nenin 76 të Kodit Familjes, nenit 112, pika 2, e ligjit 110/2018 "Për Noterinë". Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë pasuri të paluajtshme të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive tërëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur certifikata e martesës nga Akti i martesës nr. 38, datë 17.08.1981 midis Arshi MEMLIKA dhe Floresh MUÇOBEGA (MEMLIKA), lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, nr. seria 015967049 (Arkiva), lëshuar nga Qarku Gjirokastrë, Rrethi Tepelenë, datë 08.09.2020, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110/2018 "Për Noterinë".

5. Kjo dëshmi trashëgimie lëshohet në kopje origjinalë nga të cilët, njëri së bashku me pullën e taksës 200 lekë depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (për aq pasuri sa disponon trashëgimlënësi) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

6. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

7. Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkueses.

8. Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën Kompetente, në referim të nenit 97, pika 4 e ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë".

**Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Tiranë, sot më datë 05 Nëntor 2020**



ELONA L. SAKAJ

*Elona Sakaj*

21